



Fakulteti i Ekonomisë

Universiteti i Tiranës



Master Shkencor në Financë (MSHMRI)

Tema: Analiza e politikave të ndryshimeve klimatike në Shqipëri.

Lënda: Përshatje ndaj Ndryshimeve Klimatike

Punuan:

Denisa Curri

Elisa Bitri

Klea Beshaj

Miland Prendi

Xhesika Merdini

Pranoi:

Dr. Elona Pojani

Dr. Perseta Grabova

Prf. As. Narini Panariti





Përmbajtje

1.	HYRJE	3
	1.1 ABSTRAKT	3
	1.2 HYRJE.....	4
2.	TË DHËNAT HISTORIKE	5
	2.1 SI KA NDRYSHUAR KLIMA NË SHQIPËRI	5
	2.2 EFEKTET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË SHQIPËRI.....	5
	2.3 PËRMBYTJET.....	6
	2.4 NDRYSHIMI I TEMPERATURAVE.....	7
	2.5 NDRYSHIMI I NIVELIT TË DETIT.....	8
	2.6 NË GARË KUNDËR NDRYSHIMIT KLIMATIK.....	9
3.	ANALIZA E POLITIKAVE	10
	3.1 POLITIKAT KLIMATIKE NË SHQIPËRI.....	11
	3.2 SHFRYTËZIMI I PYJEVE.....	12
	3.3 PARAMETRAT INPUT TË PËRDORUR	13
	3.4 ZHVILLIMI I SEKTORIT ENER GjITIK.....	14
	3.5 PËRFUNDIME	15





Abstrakt

Ne kemi vlerësuar efektivitetin e strategjive kombëtare dhe politikave kombëtare të klimës, duke përfshirë planet e zhvillimit të ulët të karbonit, në përbushjen e qëllimeve globale të klimës dhe zvogëlimin e emetimeve të gazeve serë ndërsa përbushjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Ne vlerësojmë politikat kombëtare të cilat synojnë të rrisin transparencën dhe të inkurajojnë vendin të bëjë përpjekje për të rritur nivelin e veprimit kombëtar.

Hyrje

Çështja e ndryshimeve klimatike mund të duket me rëndësi dytësore në raport me çështjen e varfërisë, shëndetit publik, moszhvillimit ekonomik. Mirëpo, mos trajtimi i ndryshimeve klimatike mund të dëmtojë suksesin e trajtimit të këtyre çështjeve urgjente. Pra, ndryshimet klimatike gjithësesi ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, ndërsa efektet e saj kanë pasoja në cenueshmërinë e shoqërisë. Ndryshimet klimatike tani më janë duke ndodhur, ndërsa në vitet dhe dekadat e ardhshme do të rrisin ndikimin në elementet themelore të jetës kudo në botë, por edhe në Shqipëri. Ndikimet do të jenë të mëdha në rezervat e ujit, prodhimin e ushqimit, shëndetësi dhe mjedisin jetësor. Mostrajtimi i ndikimeve nga ndryshimet klimatike mund të shkatërojë çregullime të konsiderueshme ekonomike dhe mjedisore. Prandaj, është e qartë nevoja që ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj të integrohen në politikat zhvillimore, strategjitë dhe planet.

Ndikimet nga ndryshimet klimatike mund të jenë kryesisht të rëndësishme për një sektor specifik mirëpo ato mund të kenë ndikimet të ndërlydhura edhe me sektorët e tjerë. Nevoja për integrimin ndërsektorial në vendimmarrje dhe hartimin e politikave nuk është gjë e re dhe paraqitet vazhdimisht në politikat vendimarrëse që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Integrimi ndërsektorial dhe qasja ku merren parasysh pikëprerjet në mes të sektorëve në vendimmarrje është edhe një prej koncepteve themelore të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu nevoja për iniciativa për bashkëpunim ndërsektorial është e identifikuar të jetë qenësore sidomos kur adresohen nevojat për ushqim, mungesa e ujit si dhe çështjet shëndetësore që lidhen me ndryshimet mjedisore. Në kontekstin e ndryshimeve klimatike, integrimi i politikave të sektorëve të ndryshëm është një fushë relativisht e re e cila rrjedh nga integrimi i politikave mjedisore në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Ndërsa, qëndrueshmëria i definon politikat klimatike si: Inkorporim të qëllimeve të zbutjes së pasojave nga ndryshimet klimatike dhe përshtatjes ndaj tyre, në të gjitha fazat e politikave zhvillimore, strategjive dhe planeve në sektorët e tjerë (jomjedisor si dhe mjedisor), - Plotësim të përpjekjeve për të trajtuar pasojat e pritshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike si dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në një vlerësim të përgjithshëm të politikave, si dhe -





një angazhim për të minimizuar kontradiktat në mes politikave klimatike dhe politikave të tjera sektoriale. Për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit ndërsektorial, SNK në kuadër të komponentës së përshtatjes ka pare edhe implementimin e masave që do të përmirësojnë bashkëpunimin ndërsektorial, bashkëpunimin në mes të niveleve të ndryshme të administratës dhe përmirësimin e bashkëpunimit përtej kufijve administrativ.

Si ka ndryshuar klima në Shqipëri?

Ndryshimet klimatike në Shqipëri janë vrojtuar nga fundi i viteve 90, por është dimri i vitit 1997 pas të cilit, ndryshimet e klimës sa vijnë dhe bëhen më të shpeshta dhe më të qarta. Ndryshimet klimatike vrojtohen në vlerat mesatare dhe absolute të temperaturave të ajrit dhe reshjeve atmosferike që janë dhe dy elementët kryesorë të klimës. Ndryshime janë vrojtuar edhe në elementët dytësorë si numri i ditëve të nxehta apo netëve tropikale, në shtimin e valëve të nxehtësisë dhe ngricave, në kohëzgjatjen e periudhave të thata dhe shfaqjen e fenomeneve të ndryshme atmosferike jashtë muaj.

Gjithashtu, gjatë dekadës së dytë 2010 -2020, dekadë e cila filloi me përmbytjet e Shqipërisë Veriore, ku banorët e u izoluan për gati 1 muaj nga ujërat që zaptuan qarqet Shkodër, Lezhë, Kurbin dhe pjesërisht Krujën. Zona të ndryshme urbane u përballën me përmbytje të izoluara nga viti në vit deri në shkurtin e vitit 2015 kur një tjetër përmbytje e përmasave masive rrezikoi jetën dhe pasurinë e banorëve nga Fieri deri poshtë në Gjirokastrë.

Një stuhi e natyrës tropikale përfshiu Shqipërinë nga Veriu në Jug duke regjistruar reshje mbi 200 milimetra në 24 orë, reshje këto më të larta se sasitë e reshjeve mujore për shumicën e zonave perëndimore dhe jugore. Intensiteti i lartë i reshjeve në 2-3 ditë dhe prurjet e lumit Vjosa nga përtej kufirit e detyruan atë të dalë nga shtrati dhe të vërshojë në të gjithë zonën jugore duke përmbytur shtëpi dhe rrëmbyer çfarë të gjente përpara. Është pikërisht kjo dekadë që përmban dhe 5-vjeçarin më të nxehtë në historinë e matjeve klimatike; vitet 2015 – 2019 janë vitet më të nxehta në historinë e matjeve, jo vetëm në Shqipëri dhe rajon.

Rritja e nivelit të detit si pasojë e shkrirjes së akullnajave globale. Kjo rritje e nivelit të ujit është më e dukshme në brigjet e Adriatikut, të cilat jo vetëm janë gërryer, por uji ka përparuar me të paktën 50 metra në drejtim të tokës. Zaptimi i brigjeve nga uji ka pakësuar brezat e gjelbër në zonat perëndimore ndërsa në të gjithë shtrirjen Veri-Lindje-Jug, brezat pyjore janë dëmtuar nga prerja dhe djegia. Degradimi i hapësirave pyjore nga prerja pa kriter, nga djegiet për shkaqe natyrore apo ato nga dora e njeriut, vlerësohet si dëmi më i madh që shqiptarët i kanë bërë mjedisit.





Efektet e ndryshimeve klimatike në Shqipëri

Përmbytjet

Në analizat klimatike në Shqipëri dhe në rang global, paradoksi më i madh qëndron në reshjet atmosferike; është pakësuar ndjeshëm sasia e reshjeve vjetore, por janë 2-fishuar rastet me reshje intensive dhe ekstreme. Një stuhi e natyrës tropikale përfshiu Shqipërinë nga Veriu në Jug duke regjistruar reshje mbi 200 milimetra në 24 orë, reshje këto më të larta se sasi të reshjeve mujore për shumicën e zonave perëndimore dhe jugore. Janë pikërisht këto ngjarje atmosferike të cilat shkaktojnë përmbytjet e përkohshme të zonave urbane, por edhe përmbytjet masive që përfshijnë njëkohësisht 2-3 qarqe të intensiteti të lartë i reshjeve në 2-3 ditë dhe prurjet e lumit Vjosa nga përtej kufirit e detyruan atë të dalë nga shtrati dhe të vërshojë në të gjithë zonën jugore duke përmbytur shtëpi dhe rrëmbyer çfarë të gjente përpara.

Nga studimet ndërkombëtare, Shqipëria renditet në vendet me rrezikshmëri të lartë për dukuri ekstreme si përmbytjet, thatësitat dhe zjarret në pyje, por për shkencëtarët shqetësimi më i madh është se janë ulur në minimum rreshjet e dëborës dhe nuk ka më depozitim të saj në majat e maleve.

Vitet e fundit nuk janë më rreshje bore. Raporti i rreshjeve të borës me ato të shiut ka ndryshuar. Shumica janë rreshje shiu, më rrallë ka rreshje bore dhe në një sipërfaqe mbulimi më të vogël. Duke qenë se kjo digë e katrët virtuale nuk ekziston më, këto rreshje do të përfundojnë në rrjedhje sipërfaqësore në lumenj dhe në liqene, duke krijuar dhe situata përmbytjeje” - thotë Petrit Zorba i Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Gjithashtu shtojnë se ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike e rrezikojnë Shqipërinë nga ultësira perëndimore, sepse me ngritjen vetëm 5 cm e nivelit të detit aty përmbytjen hapësira të mëdha toke, që janë afër zeros ose nën nivelin e tij. Shqipëria nuk ndikon në klimën e globit, por është duke pësuar nga veprimtaria e shteteve të tjerë.

Pjesa e ultësirës tonë bregdetare është baraz ose pak më e ulët se niveli i detit. Pra, nëse deti ngrihet, jo me skenarët 100 cm, 50, apo 20, por edhe sikur të ngrihet me skenarin më minimal që po ndodh aktualisht me 5 cm, atëherë vija bregdetare hyn në thellësi të vendit deri në rrugën Lezhë - Mamurras dhe deri në rrugën Fier - Rrogozhinë - Durrës. Vendi ynë po e pëson atë që po ndodh



sot në botë. Shqipëria është një vend i viktimizuar” - thotë eksperti dhe aktivisti i mjedisit Sazan Guri.



Shqipëria ka një nivel rreshjesh 1200-1400 mm në vit. Në zona si Malësia e Madhe shkon 3500-4000 mm rreshje në vit. Në zona si Korça dhe Erseka rreshjet shkojnë 800-900 mm në vit. Këto kanë një shpërndarje jo të njëtrajtshme gjatë muajve të vitit. Periudha më me rreshje e vitit tregon një ulje të tyre, ndërkohë që në verë kemi një rritje të periudhës me thatësi - thotë z. Petrit Zorba

Shqipëria vlerësohet tani nga institutet ndërkombëtare si një vend i dekarbonizuar, për shkak të mbylljes së industrive të vjetra metalurgjike dhe mos shkarkimit të gazrave në atmosferë, por nga tjetër ajo ka dëmtuar pyjet e veta dhe nuk po kryen investime afatgjata në ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit të saj. Temperaturat vazhdojnë të mbeten 2 gradë celsius më të larta edhe tani në muajin nëntor, ndërsa rreshjet e zakonshme për stinën e vjeshtës ende janë larg mesatareve shumëvjeçare.

Table 1 | Tabela 1. Forecasts of rainfall regime change (in %) for different periods in relation to 1990 | Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve për periodha të ndryshme në raport me vitin 1990 (në %)

Years Vitet	2030	2050	2080	2100
Annual Vjetore	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Winter Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Spring Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3 to 10.75)	-14.26 (-45.1 to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Summer Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7 (-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Autumn Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Source | Burimi: ME, 2016 | MM, 2016

Ndryshimi i Temperaturave

Rritja e numrit me ditë shumë të nxehta dhe shtimi i thatësirave gjatë verës kanë bërë që numri i zjarreve në pyje, kullota apo parqe të gjelbra të ngjitet mbi 100 zjarre në vit. Ka edhe vite ku zjarret e regjistruara numërojnë mbi 300 duke bërë që në disa zona, më e dukshme në zonat Lindore të Shqipërisë, mund të udhëtosh për dhjetëra kilometra në mungesën e pemëve apo kafshëve, të shfarosura bashkë me pyjet.

Në 20 vitet e fundit, stinët po humbasin tiparet klimatike. Dimrat janë bërë më të butë dhe më të shkurtër ndërsa vera sa vjen dhe bëhet më e nxehtë dhe më e gjatë në kurriz të pranverë-vjeshtës. Vërtet dimrat janë zbutur, por natyra nuk ka harruar të sjellë periodha deri 15 ditore, me temperature shumë të ulëta ku termometri zbret deri 10 gradë nën zero edhe në zonat bregdetare, por edhe ngrica të rralla, të cilat përfshinë 100% të sipërfaqes së Shqipërisë. Nga ana tjetër, stina e verës në këto dy dekada ka thyer rekorde nga pikëpamja termike duke regjistruar temperatura të larta deri 39 gradë edhe në zonat malore si Peshkopia, Kukësi dhe Hasi, por edhe dinamika e atmosferës gjatë muajve të nxehtë rezulton shumë e pasur

Gjatë këtij 5-vjeçari, muajt e verës shënuan temperatura shumë të larta dhe spikat viti 2016, si viti me temperaturat më të larta, ku piku i nxehtësisë në qytete si Shkodra, Elbasani, Berati dhe Gjirokastra kapërcyen temperaturën prej 43 gradëve. Dhe nuk janë vetëm temperaturat e larta që



e veçojnë këtë 5-vjeçar nga periudhat e tjera, por është edhe numri i ditëve në të cilat temperaturat në mënyrë vazhdueshme shënuan vlera mbi 37 gradë Celsius. Temperaturat në Shqipëri pritet të rriten me 1.5 Gradë Celsius deri në vitin 2050 – shumë mbi rritjen prej më pak se 0.5 Gradë C të vëzhguar në vend gjatë 50 viteve të fundit.

Shqipëria ka nevojë urgjente për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura nga pemët gjatë dy dekadave të fundit dhe mbrojtjen e hapësirave pyjore ekzistuese nga zjarret. Studiuesit pohojnë se pyllëzimi do të mbrojë tokën nga gërryerjet masive të dherave. Sipas matjeve më të fundit, niveli i gërryerjeve të dheut nga shirat është rritur 12 herë; ka qenë 14 ton dhera për hektarë dhe ka shkuar 180 tonë dhera të gërryera për hektarë. Sipas studiuesve: *Gërryerja është 100 ton dhera për hektarë. Madje ka zona si juglindja, Erseka, Korça, Tomorri, Skrapari gërryerja arrin deri në 180 ton dhera për hektarë. Në kemi erodim edhe të tokave të sheshta bujqësore, edhe erodim të tokave të pjerrëta bujqësore për shkak të monokulturës, që kemi mbjellë në këto toka. Erozioni është në Shqipëri maksimal. Nuk ka vend në botë me këtë erozion; 100 ton dhera në vit nga 14 ton që është normalja; pra 8 herë më tepër se normalja.*

Niveli i Detit

Studimet mbi rritjen e nivelit të detit, shkencëtarët kanë parashikuar që rritja do të shkojë 3-6 metra në të gjithë botën deri në vitin 2100. Raportet nuk tregojnë me ekzaktësi se kur uji do të nisë të përmbysë qytetet, por emetimi aktual i gazeve serrë do ta nisë procesin e fundosjes në vitin 2200. Pra në pesë apo gjashtë breza, Shqipëria do të përballet me një det që do të rritet në një metër. Dhe nëse nuk e keni krijuar akoma idenë se çfarë impakti do të ketë rritja e detit në zonat bregdetare, mbahuni fort kur të shihni se si Kune Vain, Patok, Durrës dhe Narta në Vlorë të zhyten totalisht nën ujë.

Do të jenë sipërfaqe të tëra të këtyre zonave duke përfshirë zona të banuara dhe tokë bujqësore do të përmbysen. Sa më i lartë të jetë konsumi aktual dhe i ardhshëm i naftës, qymyrit e gazit, aq më shpejt sipërfaqet do të mbulohen nga deti. Por edhe nëse ne sot do të ndalonim së djeguri këto lëndë, ndotja me karbon që është aktualisht në atmosferë është mjaftueshëm e lartë që të krijojë një efekt në vitet e ardhshme. Plazhet në zonat e prekura nga rrëshqitjes e tokës (ato të Shëngjinit, Kune-Vain, Tale, Patok, Ishëm), dhe një numër të konsiderueshëm fushash (të përfuara në fund të viteve 1950 dhe në fillim të 1960) do të përfshihen nga përmbytjet.





Këto përmbytje do të gjejnë rrugën e tyre në segmente të rëndësishme të rrugëve lokale dhe kombëtare (duke përfshirë një pjesë të rrugës së re Fushë Krujë-Lezhë që kalon nëpër ish-Kënetën në Laç). Burime të furnizimit me ujë të pijshëm (të vendosura në Lezhë dhe Laç), si dhe shumë akomodime dhe struktura turistike të cilat kanë qenë dhe vazhdojnë të ndërtohen përgjatë këtyre plazheve. Gjithashtu, përmbytjet do të ndikojnë pjesërisht në plazhet që ndodhen në territoret që ndodhen më në lartësi (ato të Durrësit, Golemit, Divjakë, Himarë, Borshit, etj), plus infrastrukturës së turizmit në ato zona.

Në garë kundër ndryshimit klimatik

Ulja e dobësisë së sektorit bujqësor nëpërmjet përshtatjes

Më shumë se gjithçka tjetër, bujqësia mbështet jetën e popullit shqiptar, pasi siguron bazën e të ardhurave për shumicën e popullsisë dhe shërben si rrjet për sigurinë e punësimit. E gjithë kjo është në rrezik me ndryshimin e klimës. Përshtatja është çelësi i së ardhmes, përfshirë: shfrytëzimin e pyllëzimit dhe pritave për mbrojtjen e tokës së punueshme nga erozioni; përdorimi i ujitjes me pika dhe modernizimi i sistemeve ekzistuese; mbjellja e kulturave vendase që mund të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të klimës; përmirësimi i menaxhimit të arave dhe tokës, përfshirë lëvrimin minimal dhe rrethimi i të korrave me shpatet.

Përqendrimi në shërbimet mjedisore

Një projekt i miratuar rishtazi për shërbimet mjedisore, siç janë kapja e karbonit, mbrojtja e argjinaturave, furnizimi me ujë për prodhimin e energjisë, ujitje, ujë të pijshëm dhe kanalizime, do të mbështesë praktikën e menaxhimit të qëndrueshëm të tokës në zonat rurale malore të prirura për erozion dhe do të ndihmojë në ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse (si në të ardhura dhe mjete të jetesës) në komunitetet e atyre zonave.

Politikat dhe veprimet për ndryshimet klimatike





Ndryshimi i klimës ka qenë një çështje të cilës i është dhënë rëndësi në Shqipëri gjatë viteve të fundit, në kuadër të politikave të mbrojtjes së mjedisit.

Në vitin 1995, Shqipëria ratifikoi Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Në vitin 1998, Ministria e Mjedisit, përgjegjëse për aspektet klimatike, krijoi Departamentin e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike për të adresuar problematikën përkatëse, në koordinim me UNDP.

Në dhjetor të vitit 2004, qeveria ratifikoi Protokollin e Kiotos që synonte reduktimin ose kufizimin e emetimeve të gazrave të efektit serrë (GES) për vendet e Evropës Lindore me 24% nga viti bazë deri në vitin 2010 (Heyhoe, et al., 1998). Për të arritur objektivin e Konventës, u hartuan një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me: rritjen e efikasitetit të energjisë; gjetjen, zhvillimin dhe përdorimin e formave të reja të shfrytëzimit të energjisë së rinovueshme; përdorimin e teknologjive inovative në aspektin mjedisor për eliminimin e dioksidit të karbonit. Megjithatë, Shqipëria nuk arriti të përshatë dhe adoptojë masa të tilla, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në atë vendor por qe gazrat arriten te ulen me 34%.


Në Shqipëri, ndikimet e ndryshimit të klimës kanë qenë kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe energjisë dhe pritet të rriten në të ardhmen (Qeveria e Shqipërisë, 2016). Që nga ratifikimi i Marrëveshjes së Parisit 2015 në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara në Konferenca e Palëve për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) 21, shumica e qeverive kombëtare kanë miratuar masat për të ulur emetimin e gazrave serrë (GES) në atmosferë, gjë që ka një ndikim mbi modelet industriale të secilit vend.

Qeveria e Shqipërisë e ka nënshkruar dhe ratifikuar Marrëveshjen e Parisit. Megjithëse nuk është një nga kontribuesit e mëdhenj për sa u përket shkarkimeve globale të gazeve serrë, Shqipëria parashikon të jetë shumë e prekur nga ndikimet themelore të ndryshimeve klimatike. Kjo është kryesisht e lidhur me karakteristikat e saj gjeografike dhe me pozitën e saj në detin Mesdhe. Aktualisht, Shqipëria po percepton një ndikim të ndryshimeve klimatike dhe ka bërë një parashikim të tyre për të ardhmen në tre skenarë të ndryshëm për periudhat 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Të dhënat janë paraqitur në komunikimet që Shqipëria ka bërë me Bashkimin Evropian (BE) për ndryshimet klimatike. Efektet që pritet të kenë këto ndryshime përfshijnë rritjen e temperaturave, reduktimin e reshjeve dhe shtimin e thatësirave, fenomene të çrregullta atmosferike



(siç janë reshjet e dendura dhe të papritura) dhe, sigurisht, ngritjen e nivelit të detit dhe përmytjet (Ministria e Mjedisit, 2016).

Figure 1 | Figura 1. Forecasts of expected temperature rise until 2100 (°C) | Parashikimet e diferencës së rritjes mesatare të temperaturës deri në 2100 (°C)



Një nga kërkesat më të rëndësishme të UNFCCC- së për Shqipërinë është zhvillimi dhe zbatimi i politikave që kanë një ndikim të prekshëm në ndryshimin e klimës dhe efektet e tij. Kuadri ligjor i ndryshimeve klimatike nuk është ngritur ende dhe ka nevojë për përpjekje shumëdisiplinore dhe ndërsektoriale për t'u hartuar. Miratimi i Strategjisë dhe Ligjit për Ndryshimet Klimatike është hapi i parë që qeveria duhet të ndërmarrë dhe të arrijë brenda gjysmës së parë të vitit 2019. “Përpjekjet paralele duhet të adresohen të forcimi i kapaciteteve administrative dhe një financim i qëndrueshëm i sektorit” (Komisioni Evropian, 2018, pp. 86-87).

Shfrytëzimi i pyjeve të Shqipërisë për përfitim dhe klimën

Më shumë pemë do të thotë më shumë para për Shqipërinë. Shqipëria është një nga vendet e para që kap karbonin në tokën e zhveshur. Ajo po mbjell pemë dhe ndihmon pyjet të rigjenerohen pa ndërhyrjen e njeriut apo kafshëve. Nën një program të Bankës Botërore të përfunduar së fundmi, 60% e pyjeve të Shqipërisë po menaxhohen tashmë nga organet e qeverisjes vendore. Çdo komunitet përfton mbi 2,000 dollarë nga karboni i kapur. Vendi shet uljen e emetimeve, nga karboni që kapet nga pemët në rritje, me vlerë të përlogaritur në 11 milion dollarë për Fondin e Bankës Botërore për BioKarbonin.




Sektori energjetik në Shqipëri është vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike

Burimet ujore janë pasuri kombëtare Lumi Drin është burimi kryesor i energjisë elektrike për Shqipërinë. Ai furnizon me energji elektrike industrinë lokale dhe sektorin e banesave dhe siguron rreth 90 përqind të prodhimit vendas të energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë, reshjet e shiut dhe të dëborës në Shqipëri janë ndër më të ndryshueshmet në Europë. Ndërkohë që rritet kundërveprimi ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, dhe ndërsa vendet e tjera përpiqen të reduktojnë shkarkimet e gazrave me efekt serrë, mundësia e Shqipërisë për të prodhuar energji nga burime të rinovueshme thjesht rrit rëndësinë e tyre si pasuri kombëtare.

Por varësia e madhe nga energjia hidrike sjell sfida Shqipëria tashmë e ka të vështirë të plotësojë si kërkesat për energji ashtu dhe ato për të siguruar furnizim me energji, për shkak të luhatjeve të reshjeve, nga të cilat varen dhe hidrocentralet. Si rezultat, prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet mund të variojë midis rreth 6,000 GWh në vitet e lagështa deri në më pak se gjysmën e kësaj sasive në vitet shumë të thata. Në 2007 thatësira në pellgun ujëmbledhës të Drinit shkaktoi ndërprerje të gjata në furnizimin me energji elektrike, duke ndikuar si bizneset ashtu dhe qytetarët. tregon në mënyrë të qartë që ulja e prodhimit vendas të energjisë lidhet me rënien e nivelit të sasisë së reshjeve si në vitin 2002 ashtu dhe në 2007, që si rezultat është shoqëruar me rritjen e lartë të importeve të energjisë. Vlen të theksohet se, edhe me importe, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike vazhdoi.

Kështu që të dhënat e konsumit të energjisë në realitet nuk paraqesin kërkesën e vërtetë për energji gjatë asaj periudhe. Ekzistojnë dhe faktorë të tjerë, të cilët kufizojnë aftësinë e Shqipërisë për të menaxhuar këto sfida, të tilla si numri i kufizuar i linjave të interkonjeksionit në rajon dhe mungesa e efikasitetit në furnizimin vendas me energji, si dhe përdorimi i ujit. Humbjet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në vitin 2008 ishin rreth 33%. Të gjithë këta faktorë së bashku, kanë çuar në ndërprerjet e shpeshta të furnizimit me energji dhe duke sjellë pasoja në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, hidrocentralet e vegjël konkurrojnë për burimet e kufizuara ujore me sektorin e bujqësisë, i cili gjithashtu ka nevojë për ujtitje. Kjo përkeqësohet gjatë stinës së verës, kur sasia e reshjeve është më e vogël dhe bujqësia ka kërkesë më të madhe për ujë. Përdorimi më eficient i burimeve ujore në sistemin ujitës të Shqipërisë, ku 10% deri në 20% e burimeve ujore humbasin, është një mekanizëm adoptimi, i cili mund të ndihmojë të dy sektorët. Ndërkohë, po bëhen përpjekje për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar efikasitetin

e përdorimit të burimeve: Për shembull, qeveria shqiptare me një vendim të kohëve të fundit është anagazhuar të shmangë kufizimet në furnizimin me energji duke filluar nga viti 2009 e në vazhdim duke siguruar 24 orë energji elektrike. Humbjet e energjisë elektrike nga sistemi i shpërndarjes janë reduktuar me 5.5% në 2008 në krahasim me 2007, dhe humbjet nga sistemi i transmetimit ishin 3% në 2008 nga 4% humbje në 2006. Gjithashtu, si pasojë e monitorimit dhe menaxhimit më të mirë, është përmirësuar efënca e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë.



Përfundime

Shqipëria ka mundësi për të menaxhuar vulnerabilitetin e vet ndaj motit dhe klimës. Ka disa masa të rëndësishme që Shqipëria mund t'i ndër marrë që sot për të mbështetur përdorimin optimal të energjisë, burimeve ujore dhe aktivitetin e hidrocentra - leve. Ndërmarrja e këtyre hapave tani do të ndihmojë Shqipërinë për të menaxhuar më mirë luhatjet e klimës dhe për të krijuar mundësinë që vendi në të ardhmen të jetë më elastik ndaj ndryshimeve klimatike.



Përmirësimi i mënyrës se si institucionet monitorojnë, parashikojnë dhe shpërndajnë informacionin mbi kushtet meteorologjike dhe hidrometeorologjike. Shqipëria mund të zhvillojë (në vend) ose të sigurojë (nga diku tjetër) parashikimet mbi motin dhe klimën, të përshtatshme për planifikimin në sektorin energjetik, që përfshijnë parashikime afatshkurtra (1-3 ditë), parashikime afatmesme (3-10 ditë), parashikime rajonale dhe projeksione rajonale të ndryshimeve klimatike. Ky informacion mund t'i mbështesë grupet e interesuara të sektorit energjetik të ndërmarrin vlerësime të përbashkëta të rrezikut të klimës si për burimet e përbashkëta ujore ashtu dhe për rrjetet rajonale të energjisë, si dhe të bien dakort për hartimin e strategjive për menaxhimin e vulnerabiliteteve dhe rreziqeve të identifikuara klimatike.

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë me anë të reduktimit të humbjeve në sistem, duke nxitur dhe ndihmuar konsumatorët që të menaxhojnë kërkesën e tyre për energji elektrike. Përmirësimi i Planeve për Emergjencat (PE) për hidrocentralet aty ku është e nevojshme, duke marrë parasysh rritjen e pritshme të reshjeve intensive si pasojë e ndryshimeve klimatike. Prodhuesit e energjisë elektrike dhe autoritetet lokale mundet që gjithashtu të kenë nevojë për të përmirësuar kapacitetet e tyre në mënyrë që të vënë në zbatim PE, duke siguruar mekanizmat për monitorimin e motit dhe ndikimin e tij në rrjedhat e lumenjve dhe nivelet e rezervuareve, si dhe komunikimin me komunitetet që banojnë rreth këtyre zonave dhe planet urgjente për evakuimin e tyre.

Sigurimi i menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve ujore duke integruar të gjithë sektorët: energjinë, bujqësinë, furnizimin me ujë dhe kanalizimet, si dhe çështjet ndërkuftare si dhe duke marrë në konsideratë çështjet mjedisore dhe sociale.

Kërkimi i mundësive të tjera për t'u adoptuar.

Ndryshimet klimatike theksojnë si shumë të rëndësishme rritjen e diversifikimit të furnizimit me energji nëpërmjet rritjes së tregtimit rajonal të energjisë dhe një portofoli më të shumëllojshëm të aseteve të prodhimit vendas. Sa më herët që të merren në konsideratë rreziqet si pasojë e klimës në investimet e mëdha në asetet e reja që po planifikohen si dhe privatizimin e aseteve, aq më të mëdha janë mundësitë për të identifikuar dhe zbatuar zgjidhje, të cilat e bëjnë sistemin e energjisë më të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për dekadat që do të vijnë.





Koordinimi me sektorët e tjerë ofron mundësi për t'u adoptuar Aseti unik i Shqipërisë për menaxhimin e ujit.

Në të gjithë Shqipërinë ka një densitet të lartë të digave të vogla rurale; 640 rezervuarë me përmasa nga të vegjël në mesatarë, të cilët kanë një kapacitet mbajtës për të akumuluar rreth 600 milion m³ ujë. Të ndërtuara për ujitje nga vitet 1960 deri në vitet '80 ato janë sot një mundësi e rëndësishme për të racionalizuar dhe modernizuar digat, për të përmirësuar përdorimin e tyre dhe për të rritur kapacitetin e Shqipërisë për të menaxhuar ndryshueshmërinë hidrologjike, e cila po vjen duke u rritur.

Një sinergji midis shfrytëzimit të zhavorreve dhe pastrimit të shtratit të lumenjve për menaxhimin e bazenit të lumenjve. Erozioni i madh i tokës, ndërkohë që zhvillohet dhe nje fenomen natyror në territoret malore me reshje të mëdha shiu, është përkeqësuar në Shqipëri nga aktiviteti njerëzor, veçanërisht nga shpyllëzimet në vitet 1990. Volume të mëdha të sedimenteve përfundojnë në lumenj dhe rezervuare duke kërkuar kështu strategji për menaxhimin e sedimenteve. Nxitja e shfrytëzimit të zhavorreve të dherave aluviale në zonat hyrëse të lumenjve në rezervuare mund të mbështesë adoptimin.